



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. Br.Prot. Prot No. 03-03/1368/18
Data Datum 07.05.2018
Nr. flet. Nr. pages
PRISHTINE

DATE/A:	03.05.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1246/18
PËR/ZA/TO:	z. Hilmi GASHI Menaxher i zyrës së Prokurimit- Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës
CC:	z. Fehmi Mehmeti U.D-Sekretar i Presidentit të Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Furnizim me kuti dhe fasikulla për medalje” me nr. të prokurimit 102/18/2459/121, nr. të brendshëm ZPRK102/18/008/121.

I nderuar z. Gashi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Furnizim me kuti dhe fasikulla për medalje”** me nr. të prokurimit 102/18/2459/121, nr. të brendshëm ZPRK102/18/008/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Furnizim me kuti dhe fasikulla për medalje”** me nr. të prokurimit 102/18/2459/121, nr. të brendshëm ZPRK102/18/008/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin

Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyëtimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 26 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1246/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me kuti dhe fasikulla për medalje”** me nr. të prokurimit 102/18/2459/121, nr. të brendshëm ZPRK102/18/008/121, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar 42,300.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur se autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa si nën kritere i ka caktuar: 1. Çmimi të cilit i ka caktuar koeficientin prej 0,50%, nën kriteri 2. Modeli më i mirë koeficientin prej 30%, nën kriteri 3. Harmonizimi i dy modeleve me koeficient 0,10%, dhe nën kriterin 4. Afati i liferimit me koeficient 10%.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit për dhënie të kontratës nr. 4 ku është caktuar *“Afati i liferimit me koeficient 10%.”*, nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, për faktin se në nenin 28 paragrafi 3 Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, specifikohen qartë cilat kritere mund të caktohet te kriteri i dhënies Tenderi ekonomikisht ma i favorshëm. Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues mund të caktoj afatin kohor për furnizim ashtu siç parashihet ne Kushtet e veçanta të kontratës konkretisht ne nenin 19.3.

Gjatë analizimit të dosjes së këtij tenderi dhe krahasimit me njoftimin për kontratë e cila është përgatitur nga ana e autoritetit kontraktues, Agjencia ka vërejtur se nënkriteret për dhënie të kontratës nuk janë identike njëra me tjetrën më saktësisht në lidhje me nën kriterin nr. 2, ku në njoftimin për kontratë është specifikuar *Modeli me i mirë*, ndërsa në dosjen e tenderit saktësisht në Aneksin 6, te nën kriteri nr. 2. është specifikuar *Vlerësimi i kualitetit të kutisë dhe fasikullës pamja si model*. Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 27 paragrafi 4 të LPP-së, ku thuhet *“Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike”*.

Agjenci kundër Korrupsion, rekomandon autoriteti kontraktues që në rast se specifikon në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriterin për dhënie të kontratës tenderin ekonomikisht më te favorshëm, duhet të këtë kujdes që të caktoj nën kritere të qarta, precize dhe të

cilat janë kritere të matshme.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27, nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 28 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

